

(MOS) TRANSPARENCA E NDËRMARRJEVE PUBLIKE

(Analizë e nivelit të transparencës së ndërmarrjeve publike)



Autor: Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)

Me kontribut të: Aurela Mërlaku dhe Nuraje Bllaca

Redaktor: Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Dhjetor, 2022
Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Metodologjia.....	5
3. Të dhënat bazike.....	6
4. Mungesa e zyrtarëve për komunikim me publikun	7
5. Mospublikimi i vendimeve	8
6. Raportet vjetore	9
7. Informacionet mbi udhëheqësit e ndërmarrjeve publike	11
8. Qasja në dokumente publike.....	12
9. Shtojcat	13
9.1. Shtojca 1: Rangimi i ndërmarrjeve publike sipas transparencës	13
Shtojca 2: Indikatorët e aplikuar për matjen e transparencës	14

1. Përmbledhje ekzekutive

Ndërmarrjet Publike janë entitete të cilat menaxhohen nga aksionari i drejtpërdrejtë, në këtë rast Qeveria e Kosovës, por që i shërbejnë në mënyrë të pavarur të gjithë qytetarëve të Kosovës. Operimi i tyre duhet të jetë efikas, duke i rritur fitimet dhe duke i zvogëluar borxhet. Meqenëse këto i shërbejnë nevojave të qytetarëve, edhe investimet shtetërore duhet të jenë në përputhje me këto nevoja. De jure janë në pronësi të Qeverisë, de facto, ndërmarrjet publike janë të qytetarëve. Për këtë arsye, është e rëndësishme që puna e këtyre ndërmarrjeve të jetë transparente ndaj qytetarëve. Sipas Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike [3.1.1.8] ndërmarrjet publike cilësohen si institucione publike dhe i nënshtrohen obligimeve të këtij ligji për transparencë.

Përkundër kësaj, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka gjetur se ndërmarrjet publike funksionojnë në mungesë të plotë të transparencës në raport me publikun. Në faqet zyrtare të këtyre institucioneve, në shumicën e rasteve, mungojnë të dhënat bazë.

Nga 17 ndërmarrjet publike të cilat janë objekt i këtij raporti, në vetëm tri faqet e tyre zyrtare ka të dhëna në lidhje me zyrtarët për komunikim me publikun. Kështu, janë gjithsej 14 ndërmarrje publike në faqet e së cilave qytetarët nuk kanë të dhëna mbi zyrtarin për komunikim me publikun. Kjo qasje qartazi paraqet mungesë të theksuar të transparencës së këtyre ndërmarrjeve në raport me publikun.

17 ndërmarrje publike, kanë publikuar gjithsej vetëm 15 vendime. Janë gjithsej 12 ndërmarrje publike, në faqet e të cilave nuk është i publikuar asnjë vendim. Kështu, në vendimet e nxjerra nga këto ndërmarrje publike, publiku i gjerë nuk ka qasje.

Nga 17 ndërmarrjet publike objekt i këtij raporti, 7 prej tyre nuk kanë publikuar fare raporte vjetore në faqet e tyre zyrtare. Ky fakt flet për një mos transparencë të theksuar të këtyre ndërmarrjeve në raport me publikun. Ndërsa, 10 të tjera e kanë bërë këtë.

IKD ka identifikuar gjithsej 5 ndërmarrje publike, në faqet zyrtare të të cilëve nuk ka të dhëna mbi udhëheqësit e këtyre ndërmarrjeve dhe kontaktet e tyre. Kështu, në këto raste, publiku nuk ka se si ta dijë se nga kush udhëhiqet ndërmarrja e caktuar publike. Tetë ndërmarrje të tjera publike këto të dhëna i kanë publikuar vetëm pjesërisht, derisa vetëm katër ndërmarrje publike kanë publikuar plotësisht këto të dhëna në faqet e tyre zyrtare.

Kështu, gjetjet e IKD flasin për mos transparencë të theksuar të ndërmarrjeve publike në raport me publikun.

2. Metodologjia

Me qëllim të matjes së transparencës së institucioneve, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), ka ndërtuar një metodologji të thjeshtëzuar për të matur transparencën e përgjithshme të institucioneve. Indikatorët për matjen e transparencës së ndërmarrjeve publike janë nxjerrë kryesisht nga Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Sa i përket rangimit të ndërmarrjeve publike, kalkulimi i pikëve, për indikatorët e paraqitur në shtojcën 2, është bërë në këtë mënyrë: Obligim i përmbushur – 2 pikë, pjesërisht i përmbushur – 1 pikë dhe i papërmbushur 0 pikë. Për shkak të mungesës së numrit të mjaftueshëm të ankesave në AIP, indikatorët 6 dhe 7 nuk janë vlerësuar.

Indikatorët janë aplikuar në mënyrë uniforme ndaj të gjitha institucioneve që janë pjesë e vlerësimit të këtij raporti. Burimi primar i të dhënave të këtij raporti janë faqet zyrtare të institucioneve.

Ky raport i referohet transparencës së gjithsej 17 ndërmarrjeve publike. Ky raport përfshinë periudhën kohore prej 1 janar 2022 deri më 5 tetor 2022.

3. Të dhënat bazike

Ligji Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike në nenin 5.2. ka përcaktuar të dhënat bazë të cilat secili institucion publik duhet t'i ketë të publikuara në faqet e tyre zyrtare. Nga 17 ndërmarrjet publike të cilat janë objekt i trajtimit të këtij raporti, 13 prej tyre i kanë publikuar këto të dhëna, derisa katër të tjera nuk kanë publikuar fare të dhëna të tilla:

Ndërmarrja publike	A janë të publikuara të dhënat bazë
Posta e Kosovës Sh.A	Po
Telekomi i Kosovës Sh.A	Pjesërisht
Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.A	Po
Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A	Po
Operimi me Trena Hekurudhat e Kosovës "TrainKos" Sh.A	Po
Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës "InfraKos" Sh.A	Po
Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" Sh.A	Po
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A	Po
Kompania Rajonale Ujësjetësi "Prishtina" Sh.A	Po
Kompania Rajonale e Ujësjetësit "Mitrovica" Sh.A	Po
Kompania Rajonale e Ujësjetësit "Hidromorava" Sh.A	Po
KRU "Hidrodrini" Sh.A	Po
Kompania Rajonale e Ujësjetësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A	Po
Kompania Rajonale e Ujësjetësit "Gjakova" Sh.A	Pjesërisht
KRU "Drini i Bardhë" Sh.A	Po

Kompania Regjionale e Ujitjes "Radoniqi - Dukagjin" Sh.A	Pjesërisht
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "Bifurkacioni", Sh.A.	Pjesërisht

Tabela 1: Publikimi i të dhënave bazë në faqet zyrtare të ndërmarrjeve publike.

4. Mungesa e zyrtarëve për komunikim me publikun

Mungesë e theksuar e transparencës së ndërmarrjeve publike manifestohet edhe me mungesën e zyrtarëve për komunikim me publikun në këto raste. Nga 17 ndërmarrjet publike të cilat janë objekt i këtij raporti, në vetëm tri faqet e tyre zyrtare ka të dhëna në lidhje me zyrtarët për komunikim. Kështu, janë gjithsej 14 ndërmarrje publike në faqet e së cilave qytetarët nuk kanë të dhëna mbi zyrtarin për komunikim me publikun. Kjo qasje qartazi paraqet mungesë të theksuar të transparencës së këtyre ndërmarrjeve në raport me publikun.

Ndërmarrja publike	A janë të publikuara të dhënat mbi zyrtarin për komunikim me publikun
Posta e Kosovës Sh.A	Po
Telekomi i Kosovës Sh.A	Jo
Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.A	Po
Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A	Jo
Operimi me Trena Hekurudhat e Kosovës "TrainKos" Sh.A	Jo
Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës "InfraKos" Sh.A	Jo
Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" Sh.A	Jo
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A	Jo
Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Prishtina" Sh.A	Jo
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Mitrovica" Sh.A	Jo

Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidromorava" Sh.A	Jo
KRU "Hidrodrini" Sh.A	Jo
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A	Po
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Gjakova" Sh.A	Jo
KRU "Drini i Bardhë" Sh.A	Jo
Kompania Regjionale e Ujitjes "Radoniqi - Dukagjin" Sh.A	Jo
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "Bifurkacioni", Sh.A.	Jo

Tabela 2: Publikimi i të dhënave lidhur me zyrtarët për komunikim me publikun.

5. Mospublikimi i vendimeve

17 ndërmarrje publike, kanë publikuar gjithsej vetëm 15 vendime. Kjo pasi Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Prishtina" Sh.A ka publikuar gjithsej 10 vendime, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A ka publikuar dy vendime derisa nga një vendim e kanë publikuar KRU "Hidrodrini" Sh.A, Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A dhe Kompania Regjionale e Ujitjes "Radoniqi - Dukagjin" Sh.A. Andaj, janë gjithsej 12 ndërmarrje publike, në faqet e të cilave nuk është i publikuar asnjë vendim. Kështu, në vendimet e nxjerra nga këto ndërmarrje publike, publiku i gjerë nuk ka qasje.

Ndërmarrja publike	Numri i vendimeve të publikuara
Posta e Kosovës Sh.A	0
Telekomi i Kosovës Sh.A	0
Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.A	0
Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A	0
Operimi me Trena Hekurudhat e Kosovës "TrainKos" Sh.A	0
Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës	0

"InfraKos" Sh.A	
Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" Sh.A	0
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A	2
Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Prishtina" Sh.A	10
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Mitrovica" Sh.A	0
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidromorava" Sh.A	0
KRU "Hidrodrini" Sh.A	1
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A	1
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Gjakova" Sh.A	0
KRU "Drini i Bardhë" Sh.A	0
Kompania Regjionale e Ujitjes "Radoniqi - Dukagjin" Sh.A	1
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "Bifurkacioni", Sh.A.	0

Tabela 3: Publikimi i vendimeve.

Sipas Kushtetutës dhe Ligjit të aplikueshëm, të gjitha dokumentet duhet të publikohen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Edhe këto pak vendime të publikuara nga ana e ndërmarrjeve publike, të njëjtat nuk kanë respektuar parimin e dygjuhësisë, pasi në asnjë rast dokumentet nuk janë publikuar në gjuhën serbe.

6. Raportet vjetore

Raporti vjetor, përtej një formaliteti, ka një rëndësi jetike për informimin e publikut mbi punën e një institucioni. Përmes një raporti të tillë, publiku lehtësisht mund të informohet mbi të arriturat dhe sfidat e një institucioni, në rastin konkret ndërmarrje publike. Për këtë arsye, publikimi i raporteve vjetore të secilit institucion është i një rëndësie të veçantë. Për më tepër,

në rastin e ndërmarrjeve publike, publikimi i raportit vjetor të punës është edhe obligim ligjor¹.

Përkundër gjithë kësaj, nga 17 ndërmarrjet publike objekt i këtij raporti, 7 prej tyre nuk kanë publikuar fare raporte vjetore në faqet e tyre zyrtare. Ky fakt flet për një mos transparencë të theksuar të këtyre ndërmarrjeve në raport me publikun. Ndërsa, 10 të tjera e kanë bërë këtë.

Ndërmarrja publike	Publikimi i raporteve vjetore
Posta e Kosovës Sh.A	Jo
Telekomi i Kosovës Sh.A	Jo
Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.A	Jo
Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A	Po
Operimi me Trena Hekurudhat e Kosovës "TrainKos" Sh.A	Po
Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës "InfraKos" Sh.A	Po
Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" Sh.A	Jo
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A	Jo
Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Prishtina" Sh.A	Jo
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Mitrovica" Sh.A	Po
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidromorava" Sh.A	Po
KRU "Hidrodrini" Sh.A	Po
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A	Po
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Gjakova" Sh.A	Po

¹ Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 31.3.

KRU "Drini i Bardhë" Sh.A	Po
Kompania Regjionale e Ujitjes "Radoniqi - Dukagjin" Sh.A	Jo
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "Bifurkacioni", Sh.A.	Po

Tabela 4: Publikimi i raporteve vjetore.

7. Informacionet mbi udhëheqësit e ndërmarrjeve publike

IKD ka identifikuar gjithsej 5 ndërmarrje publike, në faqet zyrtare të të cilëve nuk ka të dhëna mbi udhëheqësit e këtyre ndërmarrjeve dhe kontaktet e tyre. Kështu, në këto raste, publiku nuk ka se si ta dijë se nga kush udhëhiqet ndërmarrja e caktuar publike. Tetë ndërmarrje të tjera publike këto të dhëna i kanë publikuar vetëm pjesërisht, derisa vetëm katër ndërmarrje publike kanë publikuar plotësisht këto të dhëna në faqet e tyre zyrtare.

Ndërmarrja publike	Publikimi i informacioneve dhe kontakteve të udhëheqësve të ndërmarrjeve publike
Posta e Kosovës Sh.A	Pjesërisht
Telekomi i Kosovës Sh.A	Jo
Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.A	Pjesërisht
Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A	Pjesërisht
Operimi me Trena Hekurudhat e Kosovës "TrainKos" Sh.A	Pjesërisht
Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës "InfraKos" Sh.A	Pjesërisht
Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" Sh.A	Po
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A	Pjesërisht
Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Prishtina" Sh.A	Po

Kompania Rajonale e Ujësjetës "Mitrovica" Sh.A	Jo
Kompania Rajonale e Ujësjetës "Hidromorava" Sh.A	Pjesërisht
KRU "Hidrodrini" Sh.A	Jo
Kompania Rajonale e Ujësjetës "Hidroregjioni Jugor" Sh.A	Po
Kompania Rajonale e Ujësjetës "Gjakova" Sh.A	Po
KRU "Drini i Bardhë" Sh.A	Jo
Kompania Regjionale e Ujitjes "Radoniqi - Dukagjin" Sh.A	Jo
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "Bifurkacioni", Sh.A.	Pjesërisht

Tabela 5: Publikimi i informacioneve dhe kontakteve të udhëheqësve të ndërmarrjeve publike.

8. Qasja në dokumente publike

Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), ka pranuar vetëm një numër të kufizuar të ankesave për qasje në dokumente publike. Sipas të dhënave të kësaj Agjencie, nga 17 ndërmarrjet publike objekt i këtij raporti, AIP ka pranuar ankesa për qasje në dokumente publike vetëm ndaj dy prej këtyre ndërmarrjeve publike. Ndaj Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A janë pranuar dy ankesa për qasje në dokumente publike. Në dy rastet, kjo Ndërmarrje Publike nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor andaj qasja në dokumente publike është mundësuar vetëm pas nxjerrjes së njoftimit/vendimit të AIP. Sipas të dhënave të kësaj Agjencie, Kompania Rajonale Ujësjetëse "Prishtina" Sh.A në katër raste nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor, ashtu që qasja në dokumente publike është mundësuar vetëm pas nxjerrjes së njoftimit/vendimit të Agjencisë.

Nëse i analizojmë këto të dhëna në raport me gjetjet e tjera të këtij raporti mbi transparencën e ndërmarrjeve publike, atëherë mund të konkludojmë se ndaj këtyre ndërmarrjeve publike ka mungesë të monitorimit. Kjo pasi nisur nga fakti se shumica dërrmuese e dokumenteve nuk janë fare të publikuara, është i lartë potenciali për ankesa në AIP. Fakti se këto ndërmarrje publike u përgjigjen kërkesave për qasje në dokumente publike ashtu siç është e përcaktuar me ligj duket pak i besueshëm. Veçanërisht nisur nga fakti se një numër i konsiderueshëm i institucioneve nuk kanë të publikuara fare të dhëna mbi zyrtarët për informim.

Për faktin se AIP ka pranuar vetëm një numër të kufizuar të ankesave mbi ndërmarrjet publike, ky indikator nuk ka pasur mundësi të poentohet në tabelën e rangimit të transparencës së ndërmarrjeve publike.

9. Shtojcat

9.1.Shtojca 1: Rangimi i ndërmarrjeve publike sipas transparencës

Institucioni	Pikët (Nga totali 12)
Kompania Rajonale e Ujësjetjes "Hidroregjioni Jugor" Sh.A	9
Posta e Kosovës Sh.A	5
Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT Sh.A	5
Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A	5
Operimi me Trena Hekurudhat e Kosovës "TrainKos" Sh.A	5
Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës "InfraKos" Sh.A	5
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A	5
Kompania Rajonale Ujësjetjes "Prishtina" Sh.A	5
Kompania Rajonale e Ujësjetjes "Hidromorava" Sh.A	5
KRU "Hidrodrini" Sh.A	5
Kompania Rajonale e Ujësjetjes "Gjakova" Sh.A	5
Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" Sh.A	4
Kompania Rajonale e Ujësjetjes "Mitrovica" Sh.A	4
KRU "Drini i Bardhë" Sh.A	4
Kompania Regjionale e Ujit dhe Kanalizimit "Bifurkacioni", Sh.A.	4
Kompania Regjionale e Ujitjes "Radoniqi - Dukagjin" Sh.A	2
Telekomi i Kosovës Sh.A	1

Shtojca 2: Indikatorët e aplikuar për matjen e transparencës

1. A janë publikuar të dhënat bazë mbi institucionin ?
2. A është publikuar emri dhe kontaktet e zyrtarit për qasje në dokumente publike?
3. A janë të publikuara vendimet e nxjerra?
4. A janë publikuar raportet vjetore të punës?
5. A janë të publikuara të gjitha dokumentet në dy gjuhët zyrtare?
6. A janë publikuar të dhëna mbi emrat dhe kontaktet e zyrtarëve udhëheqës të institucionit?
7. Sipas të dhënave të AIP, në sa raste institucioni nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor?
8. Sipas të dhënave të AIP, në sa raste qasja në dokumente publike është bërë e mundur vetëm pas vendimit të AIP?